



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Nënkomisioneri

Komisioneri

Rruga Ibrahim Rugova, Nr.4 Tiranë, Shqipëri, T/F.+355-47235230 E. Info.kqz@cec.gov.al, www.cec.org.al

Nr. 1628

Prot.

URDHËR I BRENDSHËM

Nr. 82 Datë 12. 10 2020

**"PËR NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR VLËRSIMIN E SISTEMEVEVE APO
PAJISJEVE TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT"**

Bazuar në nenin 19 pika 2, nenin 22 pika 1 dhe nenin 179 pika 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr.101 datë 23.07.2020,

Urdhëroj:

Ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e sistemeveve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit që do të përdoren në Zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 prill 2021, me përbërje si më poshtë:

- 1.Ylli MERKAJ, Sekretar i Përgjithshëm- Anëtar
- 2.Nexhmi MEZANI, Drejtor, Drejtoria e Teknologjisë se Informacionit- Anëtar
- 3.Ana TENOLLI, Drejtore, Drejtoria e Komisioneve Zgjedhore- Anëtar
- 4.Mirela GEGA, Drejtore, Drejtoria e Financës
- 5.Drejtori Juridik i KQZ-së - Anëtar
- 6.Ekspert i Jashtëm IT - Anëtar
- 7.Ekspert i Jashtëm IT - Anëtar

Veprimtaria e grupit të punë do të drejtohet dhe mbikëqyret nga zj. Lealba PELINKU, Nënkomisioner.



Grupi | punës ka këto detyra:

1. Të kryejë kërkime dhe të evidentojë gjetjet përkatëse në lidhje me sisteme dhe/ose pajisje të teknologjisë së informacionit, të cilat mundet të përdoren në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill, 2021, në procedurat e identifikimit elektronik të votuesit dhe në votimin elektronik;
2. Të vlerësojë mundësinë e përdorimit të këtyre sistemeve dhe/ose të pajisjeve të teknologjisë së informacionit në kushtet e vendit tonë;
3. Të bëjë një vlerësim të përgjithshëm të kostove financiare, përfshirë këtu edhe numrin e personave që do të duhet të angazhohen në përdorimin e këtyre sistemeve dhe/ose të pajisjeve të teknologjisë së informacionit;
4. Të prezantojë, për sa është e mundur, një numër subjektsh të cilët kanë zhvilluar këto sisteme dhe këto lloje pajisjesh;
5. Eventualisht të përgatisë një listë me akte juridike dhe protokolle teknike që do të bëjnë të mundur zbatimin e këtyre sistemeve dhe/ose përdorimin e këtyre pajisjeve.


Në përfundim të sa më sipër grupi i punës përgatit një raport të cilin ja dorëzon Komisionerit.

Afati i dorëzimit të raportit është data 25 tetor, 2020.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

NËNKOMISIONER

Lealba PELINKU



KOMISIONER

Ilirjan CELIBASHI

